




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	27-12-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMISHCK	8489/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.990/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.990/2022 të datës 10.11.2022 të parashtruar nga ankuesi me kundër organit të punësimit Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.990/2022 e datës 10.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Poicinë e Kosovës si nëpunës civil, përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), më datë 10.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.990/2022 me numër protokollit 7006/2022, kundër rezultatit të vlerësimit lidhur me pozitën “Inspektor i Punës” në Trupën Ekzekutive të Inspektoratit të Punës në Rajonin e Gjilanit në kuadër të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.11.2022 ankesën e ankuesit e ka dërguar tek Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës për përgjigje në ankesë. Ndërsa më datë 30.11.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokoll 7006/2022 të datës 10.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 02.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.11.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 7500/2022 e datës 30.11.2022; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë me Nr. Reference RN00009764 për pozitën "Inspektor i Punës" i datës 22.08.2022; Vendim me Nr.297/2022 i datës 23.09.2022; Ankesë e ankuesit B.Xh. e datës 27.09.2022; Shkresë për masë dicipline për B.Xh. e datës 27.09.2022; Vërtetim punësimi për B.Xh. me Nr. reference 04/01-06/SRR/0659/2022 i datës 19.09.2022; ID e B.Xh. Policia e Kosovës staf civil me Nr.0332; Vendim i Inspektoratit të Punës me Nr. protokoll 304/2022 i datës 03.10.2022; Lista e kandidatëve që e kanë kaluar verifikimin paraprak me Nr. protokoll 310/2022 e datës 03.10.2022; E-mail nga K.S. për B.Xh. i datës 11.10.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 13.10.2022; Njoftim i Inspektoratit të Punës me Nr.340/2022 i datës 31.10.2022; Lista e aplikantëve simbnj; Aplikacioni i \_\_\_\_\_ i datës 20.09.2022; ID e \_\_\_\_\_; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Juridik Qendra në Gjilan e \_\_\_\_\_ me \_\_\_\_\_ e datës 05.11.2015; Vërtetim i \_\_\_\_\_ i datës 20.09.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i \_\_\_\_\_ i datës 21.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i \_\_\_\_\_ i datës 10.02.2022; Certifikatë nga OSBE për \_\_\_\_\_ i datës 20.05.2014; Diplomë për kryerjen e shkollës së mesme Gjinnazi "Zenel Hajdini" Gjilan e \_\_\_\_\_ e datës 26.06.1993; Diplomë nga Zukunft Ardhmëria Future Gjilan e \_\_\_\_\_; Certifikatë nga Unmik për \_\_\_\_\_; Lista e aplikantëve simbnj; Aplikacioni i \_\_\_\_\_ i datës 19.09.2022; Letërnjoftim i \_\_\_\_\_; Certifikatë nga MKRS për \_\_\_\_\_ e muajt Tetor-Nëntor 2012; Vërtetim nga njësia e personelit Gjilan për \_\_\_\_\_ i datës 02.09.2022; Pasqyra e llogarisë trustit e \_\_\_\_\_ prej datës 01.08.2002 deri 01.10.2018; Akt Emërim i \_\_\_\_\_ i datës 01.10.2018; Vërtetim nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për \_\_\_\_\_ i datës 08.02.2018; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti Juridik Prishtinë e \_\_\_\_\_ me Nr.4140 i datës 24.06.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i \_\_\_\_\_ i datës 20.12.2021; Certifikatë nga IKAP për \_\_\_\_\_ i datës 22.10.2021; Certifikatë nga Care për \_\_\_\_\_ e muajt Dhjetor 2011; Certifikatë nga KCSS për \_\_\_\_\_ e muajt Nëntor 2015; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Gjilan e \_\_\_\_\_ i datës 31.10.2022; Lista e aplikantëve simbnj; Letërnjoftim i \_\_\_\_\_ Aplikacioni i \_\_\_\_\_ i datës 14.09.2022; Diplomë nga Kolegji Arberi Gjilan e \_\_\_\_\_ me nr.03/2021 i datës 08.01.2021; Vërtetim i kopjes nga origjinali nga noter. për \_\_\_\_\_; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për shërbyesit civil dhe zyrtarëve për shërbimet publike për kategorinë profesionale dhe administrative për vitin 2021 i \_\_\_\_\_; Stazhi i punës për \_\_\_\_\_ të datës 01.02.2010; Shkresë Shkeljet e nëpunësit HRIM; Certifikatë nga OSBE për \_\_\_\_\_ i datës 02.12.2011; Vendim me nr. protokoll 308/2022 i datës 03.10.2022; Akt Emërim i \_\_\_\_\_ i datës 07.03.2013; Vërtetim \_\_\_\_\_ i datës 26.09.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për shërbyesit civil dhe zyrtarëve për shërbimet publike për kategorinë profesionale dhe administrative për vitin 2020 i L.B. i datës 13.01.2021; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Gjilan e L.B. i datës 31.10.2022; Njoftim nga BNJ Inspektorati i Punës i datës 21.10.2022; E-mail nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ i datës 21.10.2022; E-mail nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_, etj. i datës 25.10.2022; E-mail nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ i datës 24.10.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, fillimisht ka trajtuar kompetencën lëndore dhe lejueshmërinë e ankesës, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave, Kolegji ka gjetur se Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës më datë 22.08.2022 ka publikuar konkursin me Nr.Reference RN00009764 për pozitën "Inspektor i Punës", ku afati për aplikim ka qenë nga data 06.09.2022 deri më datë 20.09.2022. Fillimisht ankuesi sipas vlerësimit të KVLB nuk e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak gjegjësisht sipas vendimit Nr.297/2022 dhe i njëjti është njoftuar se nuk i plotëson kushtet për lëvizje brenda kategorisë. Ankuesi duke qenë i paknaqur me këtë vendim, me datë 27.09.2022 ka parashtruar ankesë në njësinë e burimeve njerëzore në Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit për të vazhduar më tutje në procedurën e konkurimit, ndërsa njësia e burimeve njerëzore në Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës ka nxjerr vendim me Nr.protokoll 304/2022 me datë 03.10.2022 me të cilin ka miratuar si të bazuar ankesën e ankuesit, duke konstatuar se i njëjti plotëson kushtet për lëvizje brenda kategorisë. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesi, i cili në bazë të njoftimit me Nr.protokoll 310/2022 të datës 03.10.2022 është përfshirë në listën e ngushtë duke i'u nënshtruar procedurave të tjera të konkurimit për lëvizje brenda kategorisë. Pas përfundimit të rregullt të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore e Inspektoratit të Punës, ka publikuar renditjen përfundimtare të kandidatëve kur rezultoni se ankuesi është vlerësuar me gjithsej 65.6 pikë duke u renditur i treti.

Ankuesi më datë 21.10.2022 përmes emailit ka shprehur pakënaqësitë e tij lidhur me vlerësimin për këtë pozitë, mirëpo përmes emailit 24.10.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Trupës Ekzekutive të Inspektoratit të Punës, ka njoftuar ankuesin se nuk ka mandet të shqyrtoj pretendimet e tuaj ndërsa ju mund të parashtroni ankesë në pajtim me Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, duke udhëzuar për mënyrën lidhur me parashtrimin e ankesës.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave materiale konstaton se më datë 24.10.2022 ankuesi është njoftuar se mund të parashtrtoj ankesë në pajtim me Rregulloren Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën dëshmohet se ka parashtruar ankesë të brendshme pranë Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, ndërsa faktin se ankuesi nuk ka parashtruar ankesë të brendshme e ka konfirmuar edhe autoriteti punëdhënës në përgjigje në ankesë të datës 30.11.2022, si rrjedhojë bazuar në këtë ankuesi nuk ka vepruar sipas nenit 50 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Kundër rezultatit të fazës të vlerësimit, çdo kandidat i interesuar, mund të paraqesë ankesë të brendshme, brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual. 2. Ankesa shqyrtohet nga KVLBK, dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj", si dhe ndërlidhur me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të po kësaj rregullore ku përcaktohet se "Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet.



Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të lëvizjes brenda kategorisë në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme tek institucioni që Neni 31 Ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil 1. Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli"). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet. procedurën e konkurrimit për lëvizje Brenda kategorisë, prandaj pasi të shterrët kjo hap ligjor pala mundë të parashtoj ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kandidatit në procedurë të lëvizjes brenda kategorisë nuk i lejohet të parashtoj ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe"*, po ashtu ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Nisur nga ajo që u tha më lartë Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e pa lejuar dhe nuk ka trajtuar pretendimet tjera të ankuesit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.990/2022

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryeinspektorit në Inspektoratin e Punës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

